



Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
Presence in Albania

## KONKURSI PËR GAZETARËT INVESTIGATIVË 2022 FTESË PËR APLIKIM

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të mbështesë tre gazetarë shqiptarë për të marrë pjesë në një shkëmbim eksperience me kolegë ndërkombëtarë të përzgjedhur për raportimin e tyre investigativ.

Si një mjet për përzgjedhjen e pjesëmarrësve, Prezenca e OSBE-së hap konkursin duke ftuar gazetarët për të aplikuar. Konkursi synon artikujt më të mirë investigativë nga mediat e shkruara, TV, radio dhe online, duke shpërblyer investigimet më të mira për një nga temat e mëposhtme: 1) Lufta kundër Korrupsionit; 2) Qeverisja lokale; dhe, 3) Rinia ose Barazia Gjinore.

Në kuadrin e krizave të shumta që po përjeton Shqipëria, aftësitë e raportimit investigativ janë mjete thelbësore që nxisin për një panoramë më të qartë; zbulojnë dhe zgjidhin çështje të ndryshme në shoqëri; si dhe promovon praktikën më të mira të medias etike. Këto përpjekje kontribuojnë në zhvillimin e medias në vend - pjesë e mandatit të Prezencës së OSBE-së - me synimin drejt mbështetjes së gazetarisë dhe përmirësimit të kushteve të punës së gazetarëve në vend.

### **Kriteret:**

Qytetarët shqiptarë që punojnë si gazetarë

- Dëshmia e raportimit (të shkruar, online, radio ose TV) të publikuara ose të transmetuara në mediat shqiptare ndërmjet nëntorit 2021 - gushtit 2022
- Një artikull/dokumentar për çdo aplikant

**Temat e artikujve investigativë që kërkohen** (Ju lutemi zgjidhni nga sa vijon):

- Lufta kundër korrupsionit
- Qeverisja lokale
- Rinia apo Barazia Gjinore

### **Çmimet:**

- Tre fitues do të përzgjidhen, një për secilën temë. Fituesve të zgjedhur do t'u ofrohet mundësia për një shkëmbim 3-ditor ku do të vizitojnë dhe vazhdojnë një media ndërkombëtare të nivelit të lartë në një destinacion të BE-ë apo Britanisë së Madhe;

### **Kush mund të aplikojë:**

- Çdo gazetar shqiptar i akredituar, apo gazetar artikulli/dokumentari/postimi i të cilit është publikuar nga një media e akredituar për një audiencë shqiptare. Kontribuesit me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, të pavarur, dhe blogerë mund të aplikojnë për sa kohë që puna e tyre shfaqet në një media ose organizatë mediatike të akredituar dhe të licencuar.

### **Si të aplikoni:**

- Ju lutemi aplikoni **deri më 5 shtator 2022**, duke plotësuar aplikimin në linkun e mëposhtëm: <https://bit.ly/3JvaRNP>

**Aplikimi duhet të përfshijë:**

- CV
- Letër interesi
- Bashkëngjitje ose link të raportimit, ose klip të shkurtër të dokumentarit, filmit ose artikullit tuaj.

**Kërkesat e udhëtimit:**

- Aplikantët duhet të kenë/paraqesin certifikatën e vaksinimit me të paktën dy doza të një prej vaksinave të njohura ndërkombëtarisht.

Nëse keni ndonjë pyetje ose paqartësi gjatë aplikimit, ju lutemi na kontaktoni në adresën **mdu-al@osce.org**

*Raportimi investigativ ka të bëjë me të kuptuarit, zbulimin, analizën dhe komunikimin pa frikë!*